# DËSHMI ARKIVI

**A-442979**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Nga Lutfi Dervishi - Keqkuptimi me takimet e së premtes! |
| ADRESA | `https://www.syri.net/politike/916549/keqkuptimi-me-takimet-e-se-premtes/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 12:02:28 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 11:37:37 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3543eeaaa3c94f31a9df1c1d522bff4cac55c65871d62d0e35a45fc842108e0b` |
| TEKSTI | `2cf045cc3613e80465a1c0280a68c42e1c8226ffe94e82983ec22887900bb41d` |
| PAMJA | `3754e8a736b3438fd5662044d77502a4c782654b3ff4cdfdc784a118a5d20703` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4996ddda6abe9f1d027db8fe8d3b40f75e8ff058620c94ac02fef83719e7bf23` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `47dca60bb12c3dc439ebb43dab156a56f0c4323b738cbf9a7b5f92b8b605451e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4996ddda6abe9f1d027db8fe8d3b40f75e8ff058620c94ac02fef83719e7bf23`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



# Keqkuptimi me takimet e së premtes!

13:37, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

+ A - 

*Nga Lutfi Dervishi*

**Duket se ka një keqkuptim masiv për takimet e së premtes në orën 17:00. Njerëzit kanë kujtuar se do të shkojnë atje për të qarë hallet e tyre. Jo mor zotni. Do të shkoni për të dëgjuar hallet e qeverisë.**

Po të përdorim kandarin pas 13 vjetësh në pushtet, qeveria ka më shumë halle se i gjithë populli bashkë. Por shqiptarët, nga natyra janë egoistë. Mendojnë vetëm për hallin e vet.

Qeveria ka hall se rropatet ditë e natë për këtë popull dhe prapëse prapë ka të pakënaqur.

Qeveria ka hall se disa prokurorë dhe gjyqtarë ende nuk e kanë kuptuar si funksionon ndarja e punëve: tenderët, PPP-të dhe investimet strategjike janë për miqtë dhe familjarët, ndërsa ligji është për kundërshtarët.

Ka hall se njerëzit ankohen jetesa është bërë e papërballueshme, në vend që t'i shohin ato si një politikë kombëtare për mobilitetin. Kur jeta bëhet shumë e shtrenjtë këtu, qeveria po të jep mundësinë të provosh jetën diku tjetër, të provosh Europën nëse nuk ke durim deri në 2030. Po ju jepet një mundësi që, për çudi, jo të gjithë po e shfrytëzojnë, madje madje edhe po ankohen. As dembelët nuk ankohen kaq shumë.

Ka hall qeveria se dosjet e SPAK-ut dhe përgjimet interpretohen si korrupsion. Ndërkohë, po t'i lexosh me një sy tjetër, aty sheh zyrtarë dhe ministra që mendojnë 24 orë në ditë si të zhvillojnë iniciativën private. Atdheu nis te shtëpia jote- thoshte dikur një poet i njohur. Populli me të drejtë thotë: "mos prit hajër nga ai që nuk bën prokopi për veten e vet".

Ka hall se qytetarët duan ujë, rrugë, spitale, shkolla dhe paga, kur ndërkohë sapo

## më të lexuarat

Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

Berisha në Konventën Republikane në Dallas - Takime me drejtues të Departamentit të Drejtsisë, Takime me senatore

Shqiptari nga Anglia: Rama dha urdhër të mos hyjmë në shesh! Të rrimë këtu derisa ta shporrim nga zyra antishqiptarin

u është dhënë BESA, Prania Besnike dhe Pasqyrë Albania. Kjo është mungesë mirënjohjeje, për të mos thënë diçka më të rëndë, - mungesë edukate.

Ka hall se njerëzit vazhdojnë të krahasojnë pagën me çmimet. Qeveria sot e krahason me pagën e vitit 2013, qytetarët me çmimet e 2026. Janë dy metodologji krejt të ndryshme, ndaj edhe dalin dy Shqipëri të ndryshme.

Ka hall se sa herë inaugurohet një segment rruge, dikush pyet kur mbaron pjesa tjetër. Sa herë hapet një kantier, dikush guxon dhe pyet kur përfundon dhe si kurioz të sëmurë duan të dinë edhe sa kushton dhe shkojnë deri aty sa bëjnë krahasime me koston në BE. Sa herë bëhet një premtim, del ndonjë i manjak i bezdishëm që kujton premtimin e mëparshëm.

Qeveria ka hall se pas katër mandatesh qytetarët ende presin që përgjegjësinë për problemet ta mbajë qeveria. Kur dihet se për problemet e sotme përgjegjës janë qeveritë e djeshme, duke nisur nga ajo e Ahmet Zogut, opozita e sotme, mediat, gjykatat, prokurorët, BE, Rusia, ngrohja globale dhe ta themi troç edhe vetë qytetarët. Në një shoqëri të lirë, individi duhet të marrë vetë përgjegjësitë.

Qeveria ka 13 vjet që dëgjon popullin, por populli ende nuk ka mësuar të dëgjojë qeverinë.

Prandaj të premten, në orën 17:00, mos shkoni me hallet tuaja. Uluni, dëgjoni dhe tregoni pak empati se nuk ka hall më të madhe për një qeveri vizionar se një popull që nuk kupton.

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia

'Po blejnë influencë te zyrtarët e BE', Xhaferri: Rama i mori 17 miliardë lekë Universitetit të Tiranës për Kolegjin e Evropës

SYRI TV/ Karakaçi: TEC-et do jenë pronë e KESH, ERE ka shtyrë licencimin e tyre

'Diaspora nuk ka për tia falur Ramës! Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar! Dita e 105 e protestës në foto

© SYRI.net

Lexo edhe:


A do mbushet bregdeti i Semanit me parqe foto voltaike? Subashi i Fierit hap 5 tendera për dhënie me qira të 391 mijë m2 tokë


A do e lëshojë Rama, Ballukun? Berisha: Ka një tension real midis tyre pas arrestimit të Agasit


Berisha: Nuk kisha asgjë personale në përpjekjen time për një opozitë të pavarur. Kisha vetëm interes kombëtar

TË NGJASHME

Berisha: Nuk kam qenë kurrë ‘non grata’! Ata që u morën me këtë çështje kanë marrë ndëshkimin e merituar, nga McGonigal te Yuri Kim e Blinken

Berisha: Denoncoj me forcën më të madhe kërcënimet ndaj gruas dhe familjarëve të Ahmetajt me urdhër të Ramës

Berisha: Të gjitha problemet që denoncuam ne janë thënë edhe në seancën dëgjimore të Kongresit amerikan

Berisha: Diaspora na rezervoi një pritje të jashtëzakonshme. Ajo është gati të bëjë gjithçka për të ngritur përsëri në këmbë Shqipërinë

Berisha: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës! Mediat proqeveritare e censuruan fjalën e tij

Berisha: Në SHBA shprehëm shqetësimin për përdorimin e drejtësisë si armë politike nga Rama! Shqipëria, parcelë eksperimentale e Sorosit

Berisha: Denoncuam farsën elektorale, sekretari Rubio nuk e uroi Ramën për zgjedhjet! Famëzinjtë Balluku, Rama, Agasi, Lindat...

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA

SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.